

SIGURIMI I SHËNDET NË UDHËTIM

Në rast demi shëndetësor, fillimisht duhet të plotësohet pyetëtori, të cilin mund ta shkarkoni këtu.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet pranë Departamentit të Vlerësimit të Dëmeve, është:

- a) Kërkesa me shkrim, e cila duhet të jete e protokolluar, e nënshkruar dhe me adrese të sakte dhe numër telefoni për kontakt.
- b) Polica e sigurimit origjinale;
- c) Faturat origjinale të shpenzimeve mjekësorë jashtë vendit;
- d) Dokumenti i plote mjekësor që justifikon urgjencën e shërbimit;
- e) Përshkrimi i hollësishëm i diagnozës së mjekut, përfshirë këtu edhe historikun e sëmundjes dhe domosdoshmërinë e kryerjes së shpenzimeve mjekësore, raporti përfundimtar mjekësor, kopje e kartelës mjekësore;
- f) Fotokopjen e pasaportës, vulave të hyrjes dhe daljes nga kufiri;
- g) Biletat e udhëtimit.

Gjithashtu, sipas ecurisë së shqyrtimit të kërkesës për dëmshpërblim mund të kërkohen edhe dokumente të tjera.

Me paraqitjen me shkrim të kërkesës për dëmshpërblim dhe të dokumenteve të kërkuara, të cilat duhet të jene origjinale ose fotokopje të noterizuara dhe të përkthyer, do të vijohet me trajtimin e praktikës.

Në çdo rast, lexoni dhe konsultohuni, me kushtet e përgjithshme që janë dhënë në policen e sigurimit.